

Në mbështetje të nenit 5 Paragrafët 1,2,3 dhe 4,5 të Rregullores Nr 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë dhe referim të dispozitave të aplikueshme të dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe në referim të Opinionit të Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për rekrutim të brendshëm në ARKEP për shpalljen e konkursit nga MF -709-1 datë 15.03.2017 dhe nga Aprovimin nga MAP/DASHC duke ju referuar nenit 78 paragrafi 4), Udhëheqësi më i Lartë Administrativ I Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) më datë; 12 /05 /2017 autorizon publikimin e;

## Konkursit të Brendshëm për Avancim në ARKEP

### Për plotësimin e pozitës së lirë

<b>1) Titulli i pozitës:</b>	<b>Zyrtar i-e Lartë Për Kualitet Të Shërbimeve dhe Infrastrukturë</b>
Nr. i referencës së pozitës:	<b>RN.00001850</b>
Pozita:	<b>Pozitë e karrierës</b>
Puna Provuese:	<b>Dymbëdhjetë (12) muaj</b>
Kategoria Funktionale:	<b>Niveli Profesional</b>
Grada e vendit të punës:	<b>TI/730</b>
Numri i pozitave:	<b>Një (1)</b>
Vendi i punës:	<b>Prishtinë</b>

#### **I. Qëllimi i vendit të punës** (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Të përkujdeset në zbatimin e detyrave në fushën e komunikimeve elektronike, me theks të posaçëm në sferën e kualitetit të shërbimeve për t'u siguruar se do të arrihen objektivat e parapara .

#### **II. Detyrat kryesore:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia)

1. Monitoron kualitetin e shërbimeve të komunikimeve elektronike (QoS) dhe harton raporte periodike lidhur me indikatorët kryesor të kualitetit të shërbimeve si dhe raporte tjera varësisht nga situata dhe kërkesa;
2. Harton plane javore, mujore dhe vjetore lidhur me monitorimin e parametrave të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
3. Mbikëqyrë procesin e vendosjes dhe konfigurimit të pajisjeve për monitorimin e kualitetit të shërbimeve për t'u siguruar se matjet do të bëhen në përputhje me rregulloren e miratuar nga ARKEP;

4. Mbanë përgjegjësi për kryerjen në kohë, në mënyrë cilësore dhe në përputhje me rregullat dhe proceduarat e përcaktuara, të detyrave të ngarkuara të punës;
5. Raporton në baza të rregullta lidhur me përfundimin e detyrave të përcaktuara, për t'u siguruar nëse janë zhvilluar të gjitha aktivitetet dhe veprimet e planifikuara;
6. Analizon shtrirjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe harton raporte periodike (shtrirja në nivel vendi, lloji i infrastrukturës, bashkeshfrytezimi i saj, etj.) si dhe bashkërendon dhe ndërlihd aspektet e caktuara të punës, sipas nevojës me zyrtarët e tjerë të Divizionit dhe Departamentit;
7. Angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për ngritje të aftësive profesionale përmes pjesëmarrjes në programe trajnime të avancuara në temat që ndërlihdhen me mandatin e përgjithshëm të departamenti dhe detyrat kryesore nga përshkrimi i vendit të punës, për të siguruar rezultatet dhe performancën e pritur në drejtim të arritjes së plot të objektivave individuale të punës, divizionit dhe të departamentit.
8. Kryen detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret momentale të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe sipas nevojës me kërkesën e Udhëheqësit të Divizionit, dhe/apo të drejtorit të departamentit

**III. Kriteret e kërkua** (*kualifikimet, përvojat, si dhe aftësitë dhe shkathhtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës*)

- Diplomë Universitare (*Inxhinier i diplomuar*),,  
*Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - Drejtimi i Telekomunikacionit*
- Përvoja e punës profesionale (3 vjet e dëshirueshme);
- Njohja (zotërim) të gjuhës angleze – e dëshirueshme;

**Aftësitë personale;**

- Aftësi të larta analitike
- Të jetë në gjendje që të sqaroj dhe zgjidh çështje të komplikua të problemeve teknike në mënyrë të shpejtë dhe të dokumentuar;
- Aftësi të mira organizative;
- Të jetë në gjendje të punoj në presion;
- Aftësi të mira komunikative dhe në të shkruar;
- Aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, veçanërisht programeve MS Word dhe Excel.

**Data e publikimit:** 12 / 05 /2017

**Data e mbylljes së publikimit:** 19 / 05 /2017

## **V. Aplikimi;**

Aplikacioni mund të merret në Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, e cila gjendet në adresën:, *Rr.Bedri Pejani Nr. 23, Prishtinë*, ose mund të shkarkohet nga *ueb-faqja [www.arkep-rks.org](http://www.arkep-rks.org)* tek rubrika e punësimit.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmive të kërkuara sipas shpalljes për rekrutim dorëzohen pranë Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare në zarf të mbyllur; dhe/apo mund të dërgohen përmes postës elektronike në adresën elektronike; [info@arkep-rks.org](mailto:info@arkep-rks.org) ose të dërgohen përmes postës në adresën; Qyteza Pejton, Rruga 'Mujo Ulqinaku' Nr. 7, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten të dhënat personale mbi përvojën paraprake dhe gjitha kopjet e kualifikimeve (*diplomave; certifikatave të trajnimeve; dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja dhe përdorimit të kompjuterit*).

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrin e tel. 038212 345

**Njoftimi mbetet i hapur për dorëzimin e aplikacioneve 8 ditë nga dita e publikimit.**

## **VI. Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Shërbimi Civil i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, par. 3 të Ligjit *Nr. 03/L-149* për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren *Nr. 02/2010* për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohet dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.